



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Data/Datum/Date:	13. 12. 2019
Nr./Br./No	08/63
Për/Za/To:	Qytetarët e komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	z. Naim Ismajli, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Halil Halili, Drejtor i DSHP-së
Lënda/Predmet/Subject:	Njoftim – Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave

Të nderuar qytetarë të komunës së Shtimes,

Duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi, Ligjin për Mbeturina, Nr. 04/L-060 dhe Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, nr. 01-060/01-10197/19, datë 16. 4. 2019, Drejtoria e Shërbimeve Publike zhvillon aktivitete të vazhdueshme duke u fokusuar në zvogëlimin e ndotjeve dhe rritjes së hapësirave të pastërta në komunën e Shtimes. Megjithatë gjendja sa i përket mbeturinave në komunën e Shtimes nuk është e mirë. Sipas informatave të fundit vetëm 47 % e qytetarëve janë të kyçur në sistemin e grumbullimit të mbeturinave që do të thotë 57% e qytetarëve i hedhin mbeturinat në rrugë, fusha, lumë, ara ose male.

Duke marrë parasysh këto fakte, DSHP është angazhuar që fillimisht të ngritë kapacitetet e Kompanisë për grumbullimin mbeturinave dhe tani këtë e kemi arritur. Ne tani sapo kemi siguruar nga GIZ, kontejner për të gjithë qytetarët e komunës së Shtimes që dëshirojnë të përfshihen vullnetarisht në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.

Prandaj, ju njoftojmë se tani do të fillojmë aktivitetin e përgjithshëm për përfshirjen e qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave dhe të gjithë ata qytetarë që kyçen në sistem deri më 31. 12. 2019 do të furnizohen me kontejner individual për mbeturina.

DSHP-ja, ju informojnë se duke filluar nga janari i vitit 2020, të gjithë qytetarët e komunës së Shtimes do të regjistrohen në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.

Me këtë rast, përfundimisht do e ndalojmë këtë degradim dhe ndotje enorme të mjedisit tonë, vendit ku ne jetojmë, prandaj ju ftojmë që të na bashkëngjiteni dhe të përkrahni këtë aktivitet. Zotohemi se gjatë vitit 2020, pas përfshirjes së qytetarëve në sistem, ne do të eliminojmë të gjitha deponitë ilegale në komunën e Shtimes.